

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË

DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Datë : 30.12.2022

Nr: 919

**RREGULLORE E PUNËS SË KOMISIONIT TË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM**

Gjakovë

Tetor, 2021

Në mbështetje të nenit 34 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L – 087 për Ndërmarrjet Publike lidhur me nenin 20 të Ligjit nr.04/L-111 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 4 dhe nenit 17 të ligjit nr.06/L-21 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A. Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.10.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË KOMISIONIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të ndihmoj Menaxhmentin e lartë që t'i përmbush detyrimet obligimet në raport me menaxhimin e financave publike dhe t'i siguroj se ekziston një marrëdhënie efektive në mes të Menaxhmentit dhe Komisionit të Auditimit të brendshme në mënyre specifike:

1. Të ofrojë siguri të pavarur dhe objektive për Menaxhmentin e Ndërmarrjes për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të ofrojë këshilla për përmirësimin e tij.
2. Të sigurojë dhe të ofrojë vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit në Ndërmarrje.
3. Të ofrojë shërbime këshillëdhënëse në pajtim me Menaxhmentin e Ndërmarrjes, që përfshinë shërbimet e këshillimit, konsultimit dhe shërbimet e trajnimit, me qëllim që të ndihmojë Ndërmarrjen për të arritur objektivat e saj.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Komisioni i Auditimit të brendshëm ndihmon në përmirësimin e kontrollit të brendshëm të Financave të Ndërmarrjes dhe menaxhimin adekuat të parasë publike, duke mbështetur Menaxhmentin e lartë në adresimin e përgjegjësive për zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe për të siguruar që rekomandimet e Komisionit të Auditimit të Brendshëm janë trajtuar si duhet.
2. Auditimi i brendshëm ushtrohet bazuar në standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës, metodologjinë e miratuara nga Ministri i Financave dhe në pajtueshmëri me parimet, si në vijim:

- a. ligjshmërinë;
- b. pavarësinë dhe integritetin;
- c. pavarësinë dhe objektivitetin;
- d. profesionalizmin dhe kujdesin e duhur profesional; dhe
- e. kompetencën dhe konfidencialitetin;

Neni 3

Themelimi i funksionit të auditimit të brendshëm

Auditori i brendshëm emërohet nga Komisioni i Auditimit në përputhje me kriteret e miratuara nga Qeveria e Kosovës me akt nënligjor dhe vendoset si njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të Komisioni i Auditimit të Ndërmarrjes.

Neni 4

Vendosja, organizimi dhe përgjegjësitë e Njesisë së auditimit të brendshëm

1. Auditori i brendshëm vendoset në strukturën organizative si njësi e pavarur nga të gjitha funksionet tjera dhe i raporton drejtpërsëdrejti Komisionit të Auditimit.
2. Në statutin e ndërmarrjes është përcaktuar se numri i auditorëve të brendshëm është një (1) Auditor i brendshëm.
3. Njësia e auditimit të brendshëm ka pavarësi funksionale për të planifikuar, kryer dhe raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe nuk kryen detyra të tjera në kuadër të ndërmarrjes.
4. Njësia e auditimit të brendshëm nuk ndikohet nga personat me autoritet nga brenda ose jashtë Ndërmarrjes.
5. Auditori e brendshëm gjatë kryerjes së auditimit, respekton legjisllacionin e përgjithshëm në fuqi, kodin e etikës dhe sjelljes, kërkesat specifike të Ligjit si dhe kërkesat relevante të publikuara nga Njësia Qendrore Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave.
6. Komisioni i auditimit të brendshëm diskuton me Menaxhmentin - Kryeshefin Ekzekutiv lidhur me planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve, që të lehtësohet ndërmarrja e veprimeve efektive për korrigjim.
7. Auditori e brendshëm monitoron zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Neni 5

Roli i Komisionit të Auditimit të brendshëm

1. Komisioni i Auditimit ndihmon Menaxhmentin e ndërmarrjes në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të Ndërmarrjes, duke ofruar këshilla dhe rekomandime për Ndërmarrjen që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm.
2. Komisioni i Auditimit mbështet auditorin e brendshëm për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga Menaxhmenti i ndërmarrjes.

Neni 6

Përbërja e Komisionit të Auditimit të Brendshëm

1. Komisioni i Auditimit të brendshëm është organ i pavarur këshillëdhënës për Menaxhmentin e ndërmarrjes dhe mbështetës për auditorin e brendshëm.
2. Komisioni i Auditimit të Brendshëm përbehet nga tre (3) anëtar, caktohen nga radhët e Bordit të Drejtoreve, ku së paku dy (2) anëtar të caktuar në këtë mënyrë duhet të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate nga këto fusha:
 - a. Financat;
 - b. Kontabilitet;
 - c. Auditim të brendshëm;
 - d. Auditim të jashtëm;
 - e. Menaxhim të rrezikut;
 - f. Legjislacion; dhe
 - g. Teknologji informative;
3. Komisioni i Auditimit ka mandat tre (3) vjeçar, me mundësinë e riemërimit, por jo më shumë se për dy (2) mandate të njëpasnjëshme.
4. Nga radhët e Komisionit të Auditimit të Brendshëm caktohet Kryesuesi i këtij Komisioni.

Neni 7

Përgjegjësia e Menaxhmentit

1. Menaxhimet i Ndërmarrjes duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive.

Neni 8

Përgjegjësia e auditorit për auditimin e brendshëm

1. Përgatit/përpilon planet strategjike dhe vjetore të Auditimit të brendshëm dhe i dorëzon në komisionit të Auditimit për aprovim, më së largu deri më 31 Tetor të vitit fiskal.
2. Sigurojë zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

Neni 9

Funksionet dhe Kompetencat e Komisionit të Auditimit

1. Kompetencat e Komisionit të Auditimit janë ekskluzive.
2. Komisioni i Auditimit, me përgjegjësi kolektive:
 - a. do t'i përmbahet Statutit dhe Rregulloreve të Ndërmarrjes;
 - b. do t'i shqyrtojë planet afat - gjatë strategjike, të investimeve dhe financiare të Ndërmarrjes së bashku me çfarëdo ndryshim - plotësime të tyre, si dhe planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor para miratimit të tyre nga Bordi i Drejtorëve në tërësi, si dhe t'i sigurojë këtij të fundit të gjitha vërejtjet ose kundërshtimet të cilat i konsideron të nevojshme;
 - c. para miratimit nga Bordi i Drejtorëve (i) do të shqyrtojë pasqyrën vjetore të bilancit si dhe deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të Ndërmarrjes si dhe cilat do deklarata tjera financiare që kërkohen me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen industriale të Ndërmarrjes; dhe (ii) para miratimit nga Bordi i Drejtorëve do t'i dorëzojë Bordit të Drejtorëve një raport mbi përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhjen me ligjin të këtyre dokumenteve;
 - d. Rregullisht do të shqyrtojë gjendjen financiare të Ndërmarrjes dhe kushtet e saj të planifikuara financiare, si dhe do t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
 - e. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
 - f. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP-së, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt - deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;

- g. Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP të ia gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- h. do të emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë;
- i. kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas ligjit në fuqi;
- j. do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të pajiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe zyrën e auditimit të brendshëm;
- k. do t'i shqyrtojë të gjitha Transaksionet me Palët e Ndërlidhura, t'i autorizojë ato të cilat janë të arsyeshme dhe kushtet e të cilave janë të drejta për Ndërmarrjen ose, nëse aplikohen kufizimet e përcaktuara të këshillojë Aksionarin mbi arsyeshmërinë dhe drejtësinë e tyre;
- l. do t'i mbajë sekret në mënyrë rigoroze të gjitha raportet jo - anonime të cilat paraqiten nga një punonjës dhe që kanë të bëjnë me pohime për keq bërje nga një drejtor, zyrtar ose punonjës tjetër i NP-së;
- m. do të mbrojë identitetin e cilit do person i cili mund t'i nënshtrohet ndëshkimit si rezultat i paraqitjes së një raporti të kësaj natyre, dhe gjatë mbrojtjes së çfarëdo informatave përkatëse sekrete shkurtimisht të informojë punonjësin i cili ka paraqitur raportin e lartë përmendur mbi përfundimet e hetimit i cili është iniciuar si rezultat i paraqitjes së raportit nga ana e tij, dhe kur është e nevojshme, do t'i propozojë Bordit të Drejtorëve masa të cilat mund të jenë të nevojshme për zbatimin e detyrave fiduciare të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm.

Neni 10

Kompetencat e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit është i autorizuar që:

- a. t'ia udhëzojë Zyrtarin për Auditim të Brendshëm që të kryejë detyra dhe veprime të cilat janë në kuadër të kompetencave të Komisionit të Auditimit;
- b. të marrë çfarëdo informata lidhur me veprimtarinë dhe punët e NP-së nga cilido zyrtar ose punonjës i Ndërmarrjes;

- c. të kërkojë këshilla nga profesionistë të pavarur, të prokuruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, kurdo që një çështje me arsye kërkon pavarësinë e këtyre këshilltarëve nga zyrtarët ose menaxherët e lartë të NP-së;
- d. të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Bordit të Drejtorëve, dhe të tregojë agjendën e kësaj mbledhje;
- e. t'ua parashtrojë çfarëdo çështje që ka të bëjë me NP-në gjykatave ose organeve kompetente për zbatimin e ligjit;
- f. të mbajë sekret nga Bordi i Drejtorëve çfarëdo informata lidhur me aktivitetet e tij për të cilat me arsye nevojitet mbajtja e sekretit deri në përmbylljen e atij aktiviteti.

Neni 11

Mbledhjet e Komisionit të Auditimit të brendshëm

1. Takimet e Komisionit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komisionit të Auditimit.
2. Takimi mbahet nëse shumica e anëtarëve të Komisionit të Auditimit marrin pjesë në takim.
3. Në takime diskutohen çështjet sipas planit vjetor të auditimit të aprovuar nga komisioni i auditimit siç janë:
 - a. Shqyrtimi i raporteve të Njesisë së auditimit të brendshëm të pranuar në tre mujorin e parë dhe përgatitja e këshillave për Bordin e drejtorëve;
 - b. Shqyrtimi i përmbushjes së planit të Njesisë së auditimit të brendshëm në krahasim me planin e tyre vjetor;
 - c. Shqyrtimi i veprimeve të ndërmarra nga Bordi i drejtorëve për të gjitha rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe opinionet e raporteve të auditimit të jashtëm në vitin aktual;
 - d. Përgatitja dhe dorëzimi i raportit vjetor të Komisionit të Auditimit;
 - e. Çështje të tjera;
4. Në takime mbahen procesverbalet të cilat ruhen së paku shtatë (7) vjet në Njesisë e auditimit të brendshëm.
5. Bordin e Drejtorëve mund të kërkojë nga Komisioni i Auditimit të mbajë takime të tjera për të diskutuar çështje të caktuara, për të cilat ka nevojë për këshilla nga Komisioni i Auditimit.
6. Kur kërkohen informata shtesë Komisioni i Auditimit të brendshëm, fton persona tjerë të kualifikuar nga brenda ose jashtë Komunitetit për të ofruar përvojën e tyre sipas nevojës.

7. Kur është e nevojshme, Komisioni i Auditimit mund të ftojë edhe zyrtarët dhe personat tjerë me kualifikim adekuat për të marrë pjesë në takimet e Komisionit të Auditimit.
8. Zyrtari kryesor financiar dhe udhëheqësi i Njesisë së auditimit të brendshëm të subjektit të sektorit publik ofrojnë mbështetje për Komisionin e Auditimit, atëherë kur është e nevojshme dhe kur kërkohet nga kryesuesi i Komisionit të Auditimit.
9. Udhëheqësi i Njesisë së auditimit të brendshëm merr pjesë në takimet e Komisionit të Auditimit, me përjashtim kur Komisioni i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e auditorit të brendshëm të ndërmarrjes.
10. Sekretari i ndërmarrjes ofron shërbimet e sekretarisë për Komisionin e Auditimit, dhe në raste të veçanta, kur komisioni e përcakton çështjen konfidenciale, komisioni mund të caktoj njërin anëtarë që të mbaje procesverbalin e takimit.
11. Takimet, mbledhjet mbahen në lokalet e ndërmarrjes dhe në rastet të ndryshme edhe jashtë hapësirave të ndërmarrjes nëse është të nevojshme.

Neni 12

Raportet e Komisionit të Auditimit të Brendshëm

1. Komisioni i Auditimit përgatitë raport vjetor për komisionin komunal të aksionarëve i cili përfshin informatat për:
 - a. Përshtatshmërinë e mjedisit të kontrollit të brendshëm, për të siguruar funksionim efektiv, efikas dhe të ligjshëm;
 - b. Përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe mënyrat e eliminimit të tyre;
 - c. Pozitën financiare të subjektit të sektorit publik, përshtatshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe raportimin e subjektit të sektorit publik;
 - d. Ndonjë dështim madhor të sistemit që vë në rrezik subjektin e sektorit publik;
 - e. Pavarësinë e auditorit dhe efektivitetin e Njesisë së auditimit të brendshëm;
 - f. Efikasitetin e Njesisë së auditimit të brendshëm;
 - g. Shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm; dhe
 - h. Dhënien e rekomandimeve praktike tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik për përmirësimin e tyre;
2. Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit i dorëzohet komisionin komunal të aksionarëve më së largu deri më 31 Janar.

3. Komisioni i Auditimit pas çdo mbledhje, raporton me shkrim në mbledhjen e radhës së Drejtorëve për vendimet apo rekomandimet e nxjerra me rastin e Auditimit të çështjeve të caktuara, për t'i adresuar aktivitetet e caktuara financiare apo operuese të ndërmarjes.

II. Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Neni 13

Ndryshimi dhe plotësimi

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse në procedurën e aprovimit të saj.

Neni 14

Çështje tjera


Çështjet të cilat nuk janë definuar në këtë Rregullore, trajtohen drejtpërdrejtë sipas dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi.


Neni 15


Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga anëtarët e Komisionit të Auditimit të Brendshëm dhe fillon të zbatohet nga data: 01.01. 2023.


Anëtarët e Komisionit të Auditimit të Brendshëm:



Kryesues,


Anëtarë/e,


Anëtarë/e,



Gjakovë, më 27.10.2022